

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Muhamet Rexha dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses D.P.Z. “G. T. S.” me seli në Pejë, kundër të paditurave Komuna e Pejës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme me seli në Prishtinë, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me revizionet e të paditurave, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ae.nr.201/2017 datë 23.8.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 20.11.2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës Komuna e Pejës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ae.nr.201/2017 datë 23.8.2017.

PRANOHET si i bazuar revizioni i të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme me seli në Prishtinë, dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ae.nr.201/2017 datë 23.8.2017, ashtu që kërkesëpadia e paditësit që të obligohet solidarisht edhe kjo e paditur për pagesën e dëmit kontraktues, në shumë prej 392.515,00 €, i cili rezulton nga kontrata e nënshkruar nga palët ndërgjyqëse, me kamatë dhe shpenzime procedurale, refuzohet si e pabazuar.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ae.nr.201/2017 datë 23.8.2017, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës së parë dhe e të paditurës së dytë, dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike

Ek.nr.587/2016 datë 15.6.2017, i korigjuar me aktvendimin e të njëjtës gjykatë, Ek.nr.587/2016 datë 12.7.2017, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, dhe janë detyruar të paditurat që në mënyrë solidare, t'i paguajnë palët paditëse shumën e përgjithshme prej 392.515,00 €, në emër të dëmit kontraktues i cili rezulton nga kontrata e nënshkruar nga palët ndërgjyqës, me kamatë ligjore si për deponimet e afatizuara në bankat e Kosovës, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 1.7.2010, si ditë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 5.816,20 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, të paditurat me kohë kanë paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohen aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Paditësja, në përgjigjen ndaj revizionit të paditurës së parë, kontestoi në tërësi thëniet e revizionit, duke propozuar që revizioni të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për procedurë kontestimore (LPK), dhe gjeti se:

Revizioni i të paditurës së parë është i pabazuar, ndërsa revizioni i të paditurës së dytë është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja dhe të paditurat, më datë 15.9.2005, në Pejë, kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e shërbimeve, objekti i së cilës është kryerja e shërbimeve nga ana e paditëses si kompani për rimorkimin e automjeteve të cilat do të barten gjer në vendin e caktuar, respektivisht në bazën e parkingut të paditëses, sipas kërkesës së të paditurave.

Sipas nenit 2. të kësaj kontrate kryesi i shërbimeve, këtu paditësja, detyrohet që t'i bartë veturat në parkingun e saj, t'i vendosë në mënyrë të rregullt në mënyrë që të mos ndryshojë gjendja teknike e veturës, në të cilën dispozitë kontraktuese parashihen edhe detyrimet tjera të kryesit të shërbimeve.

Në nenin 3. të kësaj kontrate parashihen të drejtat dhe shpërblimi për punën që e kryen paditësja për llogarinë e të paditurave, ku në pikën 1. të këtij neni parashihet që kryesit të

shërbimeve për çdo veturë të bartur – rimorkiuar në zonën urbane ose në kuadër të qytetit i takon shpërblimi në lartësi prej 25 €, ndërsa jashtë zonës urbane, shpërblimi prej 40 €. Në pikën 2. parashihet që pas kalimit të 24 h nga momenti i rimorkimit, kryesi i shërbimeve ka të drejtë që për çdo 24 orët e ardhshme, pronarit të veturës t’ia kërkojë shumën prej 5 €, nëse pronari brenda 24 orëve të para nuk e tërheqë veturën nga depoja e kryesit të shërbimeve dhe i cili pas kësaj kohe është i obliguar që pagesën t’ia bëj kryesit të shërbimeve, duke paguar gjobën e rimorkimit dhe shumën tjetër për kohën e vonuar përtej 24 orëve të para drejtpërdrejt në zyrën e kompanisë së rimorkimit. *Në pikën 5. të këtij neni parashihet që nëse një veturë nuk tërhiqet nga pronari brenda afatit prej 90 ditësh nga dita e rimorkimit, kryesi i shërbimeve ka të drejtë të kërkojë shpenzimet e shërbimit për kohën e qëndrimit të veturës në depon e tij konform pikës 2. të këtij neni, por vetëm gjër në lartësinë e shumës së fituar në rastin e shitjes së veturës përmes ankandit publik.* Sipas pikës 6. parashihet që në rast se një veturë nuk tërhiqet nga pronari në afat prej 90 ditësh, nga dita e rimorkimit, do të konsiderohet se ajo veturë është braktisur nga pronari dhe e njëjta do të bëhet pronë shoqërore në kuptim të nenit 46 të LTHPJ. Sipas pikës 8. të këtij neni, vlerësimet për vlerën e automjeteve konform pikës 6. i bënë komisioni i përbërë nga një përfaqësues i Komunës së Pejës, SHPK-së dhe Kompanisë rimorkiuese.

Në nenin 4. të kësaj kontrate janë paraparë të drejtat dhe obligimet e porositësve të shërbimeve ku nuk është paraparë asnjë detyrim i të paditurës së dytë, Shërbimit Policor të Kosovës. *Sipas pikës 3. të këtij neni, në rast se automjeti nuk tërhiqet nga pronari në afat prej 90 ditësh dhe ajo bëhet pronë shoqërore në kuptim të pikës 5. të nenit 3, kryesi i shërbimeve ka të drejtë që të kërkojë nga porositësi i shërbimeve që këto vetura të shiten përmes ankandit publik dhe kryesi i shërbimeve të realizon shpërblimin e vet, kurse sipas pikës 4, për shitjen e veturave bashkërisht do të vendosin kontraktuesit në afat prej 60 ditësh nga dita kur konsiderohet se vetura është bërë pronë shoqërore, dhe për këtë, punën teknike është e obliguar ta bëj Komuna e Pejës (siç është shpallja e ankandit publik).* Sipas pikës 5. të këtij neni, nëse shitja e veturave nuk mund të bëhet në ankandin e paraparë për shitje, do të vendosë vet kryesi i shërbimeve në shitje të drejtpërdrejtë ose në pjesë rezervë.

Kjo kontratë ka qenë e lidhur me afat njëvjeçar, është vazhduar edhe për tre muaj në vazhdim, mirëpo automjetet e bartura në parkingun e paditësit kanë mbetur edhe më tutje aty dhe paditësja nuk ka marrë për këtë kurrfarë kompensimi .

Në këtë gjendje faktike të vërtetuar kësi soji, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se të paditurat solidarisht janë përgjegjëse për dëmin e shkaktuar paditëses, i cili konsiston në atë se për veturat të cilat paditësja i ka tërhequr sipas kësaj kontrate, parkuar në parkingun e saj dhe ruajtur, nuk ka marrë asnjë kompensim sipas kësaj kontrate, i cili dëm është vërtetuar sipas ekspertizës financiare në shkresat e lëndës, dhe në lartësinë e gjetur nga eksperti financiar, e njëjta gjykatë ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka refuzuar si të pabazuar ankesat e të paditurave, dhe ka vërtetuar aktgjykimin e lartpërmendur të gjykatës së shkallës së parë si të ligjshëm, duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të së njëjtës gjykatë.

Në një gjendje të këtillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me detyrimin e të paditurës së parë për pagesën e borxhit kontestues ndaj paditëses, por jo edhe për detyrimin solidar të paditurës së dytë për të paguar këtë borxh, kjo ngase lidhur me të paditurën e parë, këto aktgjykime nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat e paditura e parë thirret në revizion, e as me shkelje tjera thelbësore procedurale në të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në revizionin e të paditurës së parë, vetëm në mënyrë të përgjithshme thuhet se aktgjykimet e gjykatave të lartpërmendura përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pa u sqaruar konkretisht se cilat janë ato, andaj kjo Gjykatë konstaton se janë të pabazuara thëniet në revizion përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale.

Objekt shqyrtimi në Gjykatën Supreme, ishin pretendimet e revizionit se nga aktgjykimet e lartpërmendura nuk rezulton se cila është baza juridike për aprovim të kërkesëpadisë. Këto pretendime të revizionit u refuzuan si të pabazuara, kjo ngase të dy gjykatat kanë dhënë arsyë lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, të cilat janë të pranueshme edhe për Gjykatën e Revizionit. Të dy gjykatat kanë konstatuar se të paditurat janë në obligim solidar që paditëses të ia paguajnë borxhin kontestues, kjo nga se sipas nenit 15 dhe 17 të LMD-së, palët kontraktuese në marrëdhënie të ndërsjella detyimore janë të obliguara t'i kryejnë obligimet për të cilat edhe

janë përgjegjës, lidhur me përmbushjen e detyrimeve të tyre kontraktuese, andaj të dy gjykatat me të drejtë kanë vlerësuar se ekziston obligimi për pagesën e këtij borxhi në shumën e gjykuar sepse paditësja me prova të besueshme ka vërtetuar se në cilësinë e ofruesit të shërbimeve, ka kryer shërbimet e porositura, të cilat nga të paditurat edhe nuk janë kontestuar. Për më tepër nuk është kontestuar as lartësia e vlerës së këtyre shërbimeve.

Për më tepër, për faktin se në kuptim të nenit 4.4 të kontratës së lartpërmendur, e paditura e parë ka qenë e obliguar që të kryej punët teknike, siç është shpallja e ankandit publik për shitjen e veturave të cilat janë parkuar në parkingun e paditëses, pikërisht nga kjo dispozitë kontraktuese, rezulton obligimi i të paditurës së parë për pagesën e borxhit kontestues, kjo ngase e paditura e parë nuk ka kryer obligimin e vet themelor kontraktues, me kryerjen e të cilit paditësja do të kishte realizuar borxhin, i cili lidhet me parkimin disavjeçar të veturave në parkingun e saj. Vetëm e paditura e parë, këtu Komuna e Pejës, ka qenë e obliguar të shpall ankandin për shitjen e veturave, dhe mos veprimi i Komunës së Pejës ia ka pa mundësuar paditëses që të kryejë shitjen e drejtpërdrejtë të veturave, sepse shpallja e ankandit për shitjen e tyre ka qenë kusht paraprak. Për këto arsye, edhe Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se është i pakontestueshëm detyrimi i të paditurës së parë lidhur me pagesën e borxhit kontestues.

Pretendimet tjera të paditurës së parë, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerëson si të pabazuara, dhe si të tilla me pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështjeje juridike në raport me të paditurën e parë. Për më tepër ato pretendime përfaqësojnë një tendencë të pa arsyeshme të paditurës së parë për shmangie nga përgjegjësia për pagesën e borxhit ndaj paditëses, kjo nga se neni 4.4 i kontratës kontestuese, në mënyrë mjaft të qartë precizon obligimin e të paditurës së parë për kryerjen e punëve teknike rreth shitjes së veturave, si që është shpallja e ankandit publik për shitjen e tyre. Ndërsa, në kuptim të nenit 4.5 të kësaj kontrate, vetëm nëse në këtë ankand publik nuk do të shiteshin këto vetura, atëherë paditësja do të kishte të drejtë, që drejtpërdrejtë ti shet këto vetura pa ankand publik, ose ti shes si pjesë rezervë.

Mirëpo, sa i përket të paditurës së dytë, Gjykata Supreme gjen se aktgjykimet e lartpërmendura përfshihen me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, kjo ngase nga dispozitat kontraktuese të kontratës së lartpërmendur, nuk rezulton ndonjë obligim i të paditurës së dytë, ajo nuk ka marrë asnjë obligim kontraktues, kështu që pa bazë kontraktuese dhe ligjore obligohet e paditura e dytë që solidarisht me të paditurën e parë të paguaj borxhin kontestues. Nga arsyet e

cekura si dhe të dhënat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, kjo Gjykatë gjeti se kërkesëpadia e paditëses ndaj të paditurës së dytë është e pa bazuar, dhe për shkak se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, u desh që të dy aktgjykimet e atyre gjykatave të ndryshohen ashtu që kërkesëpadia e paditëses ndaj të paditurës së dytë të refuzohet si e pa bazuar.

Për arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 dhe 224.1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

E.Rev.nr.20/2017 datë 20.11.2017

Kryetari i kolegjit,
Shukri Sylejmani